

Instituti Demokratik Kombëtar

STORJET E SUKSESIT

NGA LIDERËT E SË NESËRMES



Punojmë për demokracinë dhe ndihmojmë atë të funksionojë

Prishtinë, Kosovë

Instituti Demokratik Kombëtar

STORJET E SUKSESIT

NGA LIDERËT E SË NESËRMES

Prishtinë, Kosovë
Dhjetor, 2016

PARATHËNIE

Që nga viti 1999, Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) në Kosovë ka ndihmuar qytetarët dhe liderët politikë në të gjitha nivelet të ndërtojnë një kulturë të fortë qytetare, duke krijuar institucionet të qëndrueshme, stabile dhe gjithëpërfshirëse demokratike. *Demokracia mbështetet në institucionet e tilla – zëri i qytetarisë së informuar – që të lidhin qytetarët me qeveritë e tyre dhe me njëri-tjetrin duke ofruar mundësi për pjesëmarrje në politikat publike.*

Qytetarët i gëzojnë benefitet dhe të drejtat e garantuara në një demokraci, por shpeshherë nuk i kuptojnë plotësisht përgjegjësitë e tyre si qytetarë për t'i ruajtur dhe ushtruar këto të drejta. Në mesin e këtyre përgjegjësiave janë veprimet e vetë-organizimit, angazhimi, pjesëmarrja dhe avokimi në proceset politike për të siguruar përfaqësim më të madh, përfshirje dhe drejtësisë sociale, të cilat duhet të kuptohen nga qytetarët si detyrim për arritjen e përfitimeve të qëndrueshme në një sistem demokratik. Nga ana tjetër, partitë politike duhet të organizohen dhe të jenë të gatshme që të jenë mjete për kanalizimin e politikave tek institucionet qeveritare dhe duhet të jenë proaktive për të siguruar pjesëmarrje më të madhe të angazhimit qytetar në procese politike, duke siguruar se politikat pasqyrojnë shqetësimet dhe interesat e tyre.

Me këtë libërth NDI ka kënaqësinë t'i prezantojë arritjet e një grupi të jashtëzakonshëm të kosovarëve të cilët kanë vendosur t'i trajtojnë sfidat dhe t'i kryejnë përgjegjësitë e tyre si qytetarë për të sjellë ndryshim. Ata janë aktivistë gra dhe të rinj të cilët gjatë tri viteve të fundit janë përkushtuar që të avokojnë për çështje specifike dhe të ndikojnë në procese politike, për gjetur zgjidhje për problemet në komunitetet e tyre. Që nga viti 2013, NDI ka ofruar trajnime për ngritjen e shkathtësive në angazhim efektiv politik dhe avokim për këta aktivistë gra dhe të rinj, përmes Akademisë së Grave për Leadership (AGL) dhe Shkollës për Mediat e Reja (SHMR), me financim nga Agjencia e SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përveç trajnimeve, këto programe u ofrojnë liderëve të rinj të komunitetit mundësitë për t'u rrjetëzuar dhe lidhur me njëri-tjetrin, përtej linjave partiake, gjeografike dhe etnike, për të mësuar për shqetësimet e përbashkëta dhe zhvilluar strategji për trajtimin e tyre.

Nismat që vijnë në këtë publikim janë rezultat i zotimit të fortë të liderëve të rinj, punës së palodhshme dhe gatishmërisë së tyre për t'ju dalë në krah komuniteteve të tyre dhe marrë pjesë në përcaktimin e së ardhmes së Kosovës. Çështjet e trajtuara nga këto nisma janë nxitur nga nevojat dhe interesat e komunitetit, dhe rezultatet e paraqitura këtu përfaqësojnë fitoret e tyre të para në atë që shpresojmë do të jetë fillimi i aktiviteteve të këtyre liderëve të rinj. Ato janë mundësuar me mbështetjen e USAID dhe angazhimin e palodhshëm të stafit të NDI për suksesin e këtyre nismave dhe liderëve të rinj.

Këto gra dhe këta të rinj janë frymëzim për të gjithë. Ata na paraqesin një Kosovë të re, ku pavarësisht se kush jeni apo çfarë bëni, mund punoni së bashku për të mirën e të gjithëve. Ata dëshmojnë se njerëzit e çdo moshe, gjinie apo etnie mund të bëjnë dallimin dhe se ndryshimi, sado i vogël që të jetë, është i mundur kur ka dëshirë të fortë të komunitetit dhe vullnet politik nga vendimmarrësit. Shpresojmë se do të kënaqeni duke lexuar për këto nisma njëjtë siç jemi kënaqur ne në NDI duke i mbështetur këta individë të jashtëzakonshëm dhe shpresojmë se shembujt e tyre do të shërbejnë si frymëzim për të tjerët për ta bërë hapin e parë drejt ndryshimit në Kosovë.

Alexander Chavarria
Drejtor i
Institutit Demokratik Kombëtar-Kosovë

Dhjetor 2016

Në prag të dekadës së parë që pas shpalljes së pavarësisë, Kosova ka shënuar progres të konsiderueshëm në proceset e konsolidimit të institucioneve demokratike dhe proceseve politike bazuar në vlerat dhe parimet demokratike. Partitë politike kanë filluar të zhvillojnë politika që janë më të përgjegjshme për prioritetet e qytetarëve, proceset zgjedhore janë bërë më transparente dhe më pak të cënueshme ndaj parregullsive, kuvendi ka fuqizuar kapacitetet e tij për miratimin e legjislacionit cilësor dhe ka ushtruar mbikëqyrje më të madhe të ekzekutivit, si dhe organizatat e shoqërisë civile po bëhen më efektive në artikullimin e nevojave të qytetarëve dhe ndërtimin e nismave të avokimit.

Instituti Demokratik Kombëtar për Çështje Ndërkombëtare, organizatë joqeveritare jofitimprurëse e angazhuar në forcimin dhe avancimin e demokracisë në mbarë botën, është e pranishme në Kosovë që nga viti 1999. Me mbështetjen e USAID, NDI ka punuar me kosovarët në çdo hap drejt ndërtimit të demokracisë e tyre nga baza, duke u fokusuar kryesisht në zhvillimin e partive politike dhe demokratizimit të brendshëm, monitorimin e zgjedhjeve dhe pjesëmarrjen e qytetarëve, ndërtimin dhe forcimin e institucioneve efektive, transparente dhe të përgjegjshme, si dhe avancimin e kapaciteteve të dhe avokimit të organizatave të shoqërisë civile. Gjithashtu, NDI angazhohet në hapjen e rrugëve për dialog ndëretnik për t'i lehtësuar përpjekjet drejt transformimit të konfliktit dhe pajtimit të qëndrueshëm etnik.

Aktualisht, NDI është duke zbatuar Programin e Proceseve Politike dhe Mbështetjes Parlamentare në Kosovë, financuar nga Agjencia e SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar. Qëllimi i përgjithshëm i programit është të forcojë lidhjet midis qytetarëve, partive dhe institucioneve, për të nxitur dhe orientuar qeverinë që të jetë më e përgjegjshme karshi interesit publik. Një mënyrë përmes së cilës është duke punuar Instituti drejt arritjes së kësaj është nxitja e pjesëmarrjes kuptimplote të grave, të rinjve dhe pakicave në politikë, si aktivistë të komunitetit, anëtarë të partive politike dhe përfaqësues të zgjedhur.

NDI beson se demokracia e Kosovës do të forcohet atëherë kur aktivistë të shoqërisë civile dhe aktivistë politikë, sidomos gra, të rinj dhe pakica, fuqizohen në identifikimin, realizimin dhe sigurimin e zbatimit të avokimit të bazuar në çështje, shndërrimin e nismave të avokimit në politika efektive, si dhe rritjen e presionit mbi ligjvënësit për të kërkuar llogari nga ekzekutivi i nivelit lokal dhe qendror.

Si pjesë e mbështetjes së saj për partitë politike, NDI ka punuar me lidërsipin e tyre për të nxitur demokraci të brendshme, me fokus të veçantë në ofrimin e hapësirave më të shumta për gratë dhe të rinjtë që të marrin përsipër role udhëheqëse dhe të investojnë në rritjen e kapaciteteve të tyre. Akademia e Grave për Lidërsip dhe Shkolla e Mediave të Reja janë dy shembuj që ilustrojnë qasjen metodologjike që mbledh në një vend gra dhe të rinj në mjedise ndërpartiake për të mësuar shkathtësi dhe teknika të reja që do t'i rrisin aftësitë e tyre dhe do t'i shndërrojnë ato në burime të vlefshme për partitë e tyre përkatëse politike. Duke punuar në fuqizimin e lidërsipit të ri dhe krijimin e lidhjeve me përfaqësues politikë, NDI mund ta inkurajojë lidërsipin në nivel qendror dhe në nivel të degëve që të sigurojë përfshirje edhe të individëve që dalin nga niveli bazik dhe të sigurojë që ata angazhohen tërësisht në proceset politike.



Ferizaj, qytet i vogël, idilik, i vendosur në jug të Kosovës, është simbol i tolerancës fetare, me Xhaminë e Madhe të Mulla Veselit dhe Katedralen e Shën Uroshit të pozicionuara krah për krah. Qyteti gjithashtu mburret me një fenomen të rrallë natyror, që quhet bifurkacioni, ku lumi Nerodime, i cili kalon nëpër qytet, degëzohet në dy rrjedha të ndara.

Përgjatë viteve lumi është degraduar rëndë, duke rrezikuar që të shteret nga përdorimi dhe neglizhenca e tepruar. Në vitin 2015, Herolind Zariqi vendosi të bëjë diçka për këtë.

“Kam vendosur që ta trajtoj këtë çështje pasi që unë vij nga qyteti i Ferizajt, dhe për shkak se [bifurkacioni] është edhe fenomen natyror edhe interes kombëtar, dhe vendosa ta trajtoj atë me seriozitet”, tha Zariqi.

Zariqi, pjesëmarrës i Shkollës së Mediave të NDI, themeloi nismën ‘Bifurkacioni’ dhe filloi rrugëtimin e tij për ta shpëtuar dhe mbrojtur lumin Nerodime.

“Unë isha i vetmi anëtar i nismës, por me mbështetjen e NDI, nuk kam pasur shumë probleme”, tha Zariqi. “Unë kontaktova me njerëzit e duhur dhe e adresova çështjen në Kuvendin Komunal të Ferizajt”, tha Zariqi.

Gjatë muajit shtator 2015, Zariqikrijoi kontakte me kuvendin komunal të Ferizajt për ta prezantuar propozimin e tij. “Fillova duke kontaktuar këshilltarët e kuvendit komunal që i përkasin Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Ferizaj, të cilët ranë dakord që



BIFURKACIONI

ta trajtojnë çështjen në kuvend komunal. Më pas, kryetari i komunës së Ferizajt mirëpriti idenë dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit filloi procesin e revitalizimit të fenomenit të bifurkacionit”.

“Unë nuk arrita t’i përdor mediat sociale aq sa doja sepse nisma ishte e njohur vetëm në nivel lokal, dhe shumë njerëz nga komunat tjera nuk kishin dëgjuar për fenomenin e [bifurkacionit]”, theksoi Zariqi.

Pas një procesi të gjatë të avokimit dhe takimeve me zyrtarë të komunës, Kuvendi Komunal i Ferizajt miratoi vendimin 01/No.96 dhe shpalli sipërfaqen prej 15 ha, si zonë të përkohshme të mbrojtur si Monument i Natyrës.

“U ndjeva shumë mirë pasi i aprovua vendimi, por unë nuk mund ta quaj këtë sukses të vërtetë kohë pas kohe paraqiten probleme të reja për shkak se disa njerëz e keqpërdorin lumin ose e dëmtojnë atë, duke mos u ndëshkuar”, theksoi Zariqi.

Pasi u aprovua vendimi, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor filloi procedurat për përgatitjen dhe aprovimin e kornizës së nevojshme ligjore për shpalljen e saj si zonë të mbrojtjes së veçantë.

I tërë procesi i restaurimit dhe konservimit nga Ministria e Mjedisit u finalizua më 5 qershor 2016, në Ditën Botërore të Mjedisit, dhe u inaugurua nga Kryeministri i Kosovës, Ministri i Mjedisit, si dhe kryetari i komunës së Ferizajt.



Zariqi bën thirrje rinisë kosovare që të jetë më aktive për shkak se, sipas tij, arritja e ndryshimit është më e lehtë se që besojnë njerëzit.

“Unë dua që të rinjtë të jenë sa më aktivë në nisma të ndryshme, sepse në sajë të organizatave si NDI, mundësitë për t’i zgjidhur problemet dhe për t’i përmbushur objektivat në komunitetet tona kurrë nuk ka qenë më të mëdha,” tha ai.

Kjo nismë është kryer nga pjesëmarrësi i Shkollës së Re Mediale Herolind Zariqi.



Rijetësimi, ruajtja dhe mbrojtja e lumit Nerodime i cili është vetmi lum në Evropë që ndahet në dy degë dhe derdhët në dy dete të ndryshme.



Çështja e bifurkacionit është në Agjendën Komonale; Lumi është në mbrojtje të Ministrisë



Mbledhja e mbështetjes online



Komuna e Ferizajt ta deklarojë këtë zonë si monument të mbrojtur natyror; Ministria e Mjedisit ta ruajë, rijetësoj dhe mbrojë këtë lum.



Lumi është paraqitur si zonë e mbrojtur dhe Ministria e Mjedisit e ka marrë atë në mbrojtje



Zhvillimi i qëndrueshëm nuk arrihet vetëm me rregullime politike. Ai kërkon edukim kualitativ dhe shumë mundësi punësimi. Si shteti më i ri në Evropë, Kosova ka edhe popullatën më të re në Evropë, duke qenë se 53 për qind të qytetarëve të saj janë nën moshën 25-vjeçare. Ajo gjithashtu ka edhe normën më të lartë të papunësisë në rajon (35 për qind) dhe normën më të lartë të papunësisë tek rinia (rreth 60 për qind).

Në vitin 2015, të rinjtë që morën pjesë në Shkollën e Re për Media të NDI parashtuan hipotezën që një nga arsyet e normave aq të larta të papunësisë është pakënaqësia e shprehur e punëdhënësve me kualifikimet e punëkërkuësve, duhet të jetë hende ku mes ofertave në sistemin arsimor të Kosovës dhe kërkesës së punëdhënësve potencialë.

“Fillimisht ishte vetëm hipotezë, e bazuar në pak informata dhe perceptimet e disa kontakteve tona” thotë Dren Dushi, një nga të rinjtë. “Hipoteza ishte që tregu i punës vendin tonë nuk përkonte me sistemin tonë arsimor. Pas kësaj filluam ta hulumtojmë këtë çështje.”

Grupi Themeloi nismën “Arsimi për Punësim” për të hulumtuar mënyrat për të zvogëluar hendekun mes nevojave të tregut të punës dhe sistemit arsimor në Kosovë.

“Hapi i parë ishte të hulumtohet struktura e sistemit arsimor tonë dhe historiku i reformave në arsim,” thotë Dushi. “Për të bërë këtë, ne kemi biseduar me profesorë, pasi që ata bartin barrën e ndërtimit të një sistemi arsimor cilësor. Më pas i kemi anketuar bizneset lokale për të kuptuar se cilat profesione, shkathtësi dhe specializime priten nga punëmarrësit potencialë.”

Gjatë fazave preliminare të hulumtimit, grupi ka vënë në spikamë një sërë temash që mungonin në planprogramin kombëtar, siç ishin shkathtësitë e buta të ndërlidhura me të folurit në publik, teknologjinë informative dhe të komunikimit, si dhe shkathtësitë e komunikimit dhe debatit. Grupi gjithashtu arriti tek përfundimi se kushtet e dobëta të stabilimenteve si laboratorët dhe hallat sportive, dhe ndikimi politik në universitete janë problemet më të mëdha. Profesorët e universiteteve kanë vërejtur se cilësia e gjithmbarshme e studentëve sa shkon e bie, dhe kanë shprehur brengë lidhur me mosgatishmërinë e nxënësve për të vazhduar shkollimin e lartë. Hulumtimi i këtij grupi gjithashtu identifikoi probleme që ndërlidhen me mungesën e bibliotekave, humbjen e orëve nga profesorët dhe studentët, motivimin e ulët të studentëve për të mësuar në fushat të caktuara që nuk kanë potencial të lartë për punësim.

“Një nga problemet është numri i madh i studentëve që diplomojnë në një fushë të caktuar, si dhe numri i vogël i studentëve në fusha tjera ku ka më shumë kërkesë, siç janë teknologjia informative (TI) dhe bujqësia,” thotë Dushi. “Ne besojmë se këto profesione duhet të promovohen në bazë të kërkesave të tregut.” Përveç kësaj, nisma vrojtoi se profesorët kanë tepër punë dhe paguhen pak, ndërsa që shumë prej tyre kanë edhe punë sekondare si profesorë në universitete private.

Nisma e kreu hulumtimin me mbi 100 biznese lokale, duke kërkuar informata mbi trendet e punësimit në Kosovë. Shumica dërmuese e bizneseve shpreheshin se shkathtësitë kryesore të një punëmarrësi potencial duhet të jenë ato që lidhen me kalkulimin, shkrimin dhe gramatikën dhe aftësitë për të punuar në grup. Hulumtimi gjithashtu nënvizonte se punëmarrësit potencialë që kanë përvoja paraprake të punës, që njohin gjuhë të huaja dhe punën në TI kanë përparësi në punësim. Mbi 30 për qind të bizneseve të anketuara shprehin pakënaqësitë me punëmarrësit potencialë të arsimuar në sistemin arsimor të Kosovës, ndërsa 60 për qind ishin deri diku të kënaqur me punëkërkuësit.

“Të gjitha statistikatat që i kemi nxjerrë janë të rëndësishme, sepse janë të ndërlidhura me njëra – tjetrën,” tha Valmir Gashi, një tjetër anëtar i nismës. “Por, gjetjet kryesore janë ato që ndërlidhen me kërkesën e madhe në tregun e punës për gjeneratat e reja të punëmarrësve... ka pakënaqësi me atë që aktualisht prodhohet nga sistemi arsimor.”

Nisma ka arritur tek përfundimi se sistemi arsimor duhet t’i nënshtrohet një ndryshimi radikal, për të plotësuar nevojat e tregut të punës, ndërsa anëtarët e saj besojnë se për të realizuar një ndërrim të tillë, arsimi duhet të shndërrohet në prioritet të qeverisë dhe të gëzojë përkrahje financiare. Anëtarët e nismës deshën t’ia bëjnë të ditura gjetjet e tyre Ministrisë së



ARSIMI PËR PUNËSIM

Arsimit, andaj caktuan një takim për t'ia paraqitur Ministrit të Arsimit, z. Arsim Bajrami, hulumtimin mbi sistemin shtetëror të arsimit në Kosovë. Nisma ka ofruar një listë rekomandimesh dhe hapash konkret për përmirësim të situatës, përfshirë këtu pasurimin e planprogramit me shkathtësitë e duhura për tregun e punës, siç janë njohja e TI-së, shkathtësitë e debatit, gjuhët e huaja dhe aftësitë komunikuese.

Ministri i Arsimit e ka ftuar nismën në Konventën Kombëtare të Arsimit, ku do të jenë të pranishme biznese dhe universitete të ndryshme. Atje, nisma pritet të paraqesë gjetjet dhe rekomandimet e veta.

Anëtarët e nismës kanë thënë se lidhja e sistemit arsimor me tregun e punës nuk është punë e vogël, por se ata mund të jenë në rrugë të duhur. "Puna jonë sapo ka filluar," thotë Gashi. "Lidhja e sistemit arsimor me nevojat e tregut të punës është çështje tejet komplekse, por ne duhet të vazhdojmë punën në ofrimin e rekomandimeve specifike të cilat, mbi të gjitha, janë të qëndrueshme dhe të zbatueshme në mënyrë që të mund të realizohen sa më shpejt që të jetë e mundur."

Anëtarët e nismës:

Dren Dushi, Valmir Gashi, Garip Sahiti
Fidane Hasani, Tringa Kasemi



Të ketë harmonizim më të madh në mes të ofertave të universitetit dhe nevojave të tregut të punës për të mbështetur punësimin e të rinjve

Recommend

Ministria e Edukimit dhe Ministria e Punës duhet të rishikojnë kurikulat mësimore dhe akreditimet e universiteteve



Mbledhja e mbështetjes institucionale dhe të asaj online



Organizimi i tryezës së rumbullakët me palët e interesuara



Institucionet qeveritare fillojnë rishikimin e programeve universitare dhe kurrikulave të arsimit



 /facedogkosova

Kosova ka problem serioz me qentë endacakë. Aktualisht, nuk ka të dhëna për shtirjen e këtij problemi, por prania e tij shihet qartas. Përveç kësaj, ka mungesë të strehimoreve rajonale të qenve, si dhe mungesë të vetëdijesimit publik për mënyrat e adoptimit të qenve të strehimoreve. Shpeshherë, qentë endacakë në Kosovë braktisen, abuzohen fizikisht apo keqtrajtohen në mënyra të tjera dhe disa herë edhe vriten.

Edhe pse legjislacioni i Kosovës ndalon vrasjen e kafshëve endacake, në vitin 2013, pothuajse të gjitha komunat kanë autorizuar eutanazinë, madje shpesh duke shpallur konkurse për kompanitë për kryerjen e këtyre shërbimeve.

Të indinjuar me mënyrën se si trajtoheshin kafshët endacake nga zyrtarët komunalë, Fitim Sylejmani dhe gjashtë miq të tij themeluan nismën vullnetare "Facedog Kosova" me mbështetjen e Shkollës së Mediave të Reja të NDI, për të avokuar për marrjen e masave të menjëhershme për ta ndërprerë praktikën e vrasjes së qenve endacakë në Kosovë.

Duke shfrytëzuar *Facebook* dhe *Twitter*, fushata u angazhua në rritjen e vetëdijesimit mbi adoptimin e qenve endacakë dhe promovimin e hapjes së strehimoreve rajonale të qenve.

"Nisma është krijuar nga një grup adhuresish të kafshëve. Qëllimi ishte që të ndalet praktika e vrasjes së qenve endacakë, avokimi tek komunat e ndryshme për trajtim profesional të qenve endacakë dhe organizimi i fushatave të ndryshme vetëdijesimi", tha Fitimi.



FACEDOG KOSOVA

Kur u formua kjo nismë nuk kishte strehimore funksionale të kafshëve në Kosovë. Nisma lobi me ngulm për krijimin e strehimoreve në komunat në mbarë Kosovën, meqë ata mendonin kjo do të rriste në masë madhe sigurinë e qytetarëve dhe do të kontribuonte në një trajtim më human të kafshëve.

Një vit më vonë, u hapën strehimoret e tilla në disa komuna. Por, në nëntor të vitit 2014, fotografitë e rrjedhura treguan se ajo që kishte filluar si strehimore në komunën e Pejës u shndërrua në thertore.

"Ne u ndiem shumë keq kur i pamë ato fotografi. Së pari reaguam në media dhe kërkuam takim me kryetarin e komunës," tha Fitimi. "[Takimi] u mbajt pas disa ditëve dhe situata u përmirësua."

Ndërkohë në qytetin e Mitrovicës vazhdonte kontraktimi i kompanive për vrasjen e qenve të rrugëve. Trendet e vrasjes dhe abuzimit të qenve endacakë janë vërejtur në shumicën e komunave, por ato ishin pjesë të një problemi më të madh: mungesa e përgjithshme e vetëdijesimit tek qytetarët lidhur me keqtrajtimin e qenve endacakë, dhe kultura joadekuate institucionale me trajtimin e kafshëve endacake.

Nisma dënoi ashpër aktet e abuzimit të kafshëve të rrugës përmes një numër deklaratah publike. Takimet me liderët komunal vazhduan, me qëllim të propozimit të rekomandimeve kyçe për përmirësimin e trajtimit të kafshëve endacake nga pikëpamja institucionale.

Përveç kësaj, ata kanë ndërmarrë aktivitete të ngritjes së vetëdijesimit, duke përfshirë shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Ditës së Kafshëve në bashkëpunim me organizatat e tjera të të drejtave të kafshëve në Kosovë. "Disa prej aktiviteteve më të rëndësishme që i organizuam këtë ditë ishin ofrimi i ushqimit për qentë endacakë në rrugët e Kosovës nga aktivistët dhe qytetarët, shpërndarja e fletëpalosjeve, si dhe kumtesat për shtyp dhe konferencat kur kundërshtuam eutanazinë e qenve endacakë," tha Leonida. "Aktivitetet tona janë mbuluar edhe nga mediat."


Nisma ftoi njerëz nga e tërë Kosova që t'ju bashkohen në përpjekjet e tyre. Më shumë se 100 fotografi që paraqesin të ushqyerit e kafshëve endacake u paraqitën në mediat sociale. "Ishte aksion shumë i suksesshëm. Ne u bëmë pjesë e organizimit të përpjekjeve mbarëbotërore në këtë ditë," tha Fitimi.

Tri vite më vonë, trajtimi i përgjithshëm i qenve endacakë është përmirësuar dhe komunat kanë filluar të ndajnë fonde për trajtim më të mirë të tyre. Nisma ende vazhdon të monitorojë komunat dhe të reagojë kurdoherë që ato ndërmarrin veprime të paligjshme ndaj qenve endacakë.

Arber Salihu, anëtar i nismës, theksoi se ndonëse ka shumëçka për t'u bërë, ai është i kënaqur me arritjet e grupit në këtë drejtim drejt trajtimit më të mirë të qenve endacakë. "Së paku, kemi arritur që trajtimi i qenve endacakë të ngrihet si temë diskutimi. Jemi të lumtur që çdo ditë ka nisma të reja për mbrojtjen e kafshëve dhe qenve endacakë në veçanti, ndërsa kur kemi filluar me nismën tonë ishin shumë pak sosh," tha Arbëri. "Para disa viteve ishte vetëm një komunë që kishte ndaluar praktikën e vrasjes së qenve endacakë, ndërsa sot komunat diskutojnë për mënyrat më të mira të ndërtimit të strehimoreve të reja."

Anëtarët e nismës:

Fitim Sylejmani, Isuf Zejna, Leonidë Molliqaj, Rumir Zhuniqi, Shkumbin Hyseni, Arbër Salihu, Arjetë Fetahu





 /RightRepresentation

Në vitin 2013, një grup i të rinjve që merrnin pjesë në Shkollën e Mediave të Reja të NDI-së, vendosi të kryej një hulumtim për të zbuluar nivelin e nënpërfaqësimit të grave në politikën e Kosovës, e posaçërisht në nivelin lokal.

“Marrë parasysh raportimet mbi mospajtueshmërinë me Ligjin për Barazi Gjinore dhe ligjet tjera që prekin pozitën e grave në shoqëri, ne vendosëm t’i qasemi çështjes “Gratë në vendimmarrje në nivel lokal,” me qëllim të përmirësimit të situatës aktuale,” thotë Saranda Bllaca, anëtare e nismës. Ky grup rinor themeloi nismën ‘Përfaqësim të drejtë për gjysmën e popullatës’ dhe filloi një fushatë që fokusohej në ngritjen e vetëdijes lidhur me përfaqësimin e barabartë gjinor në institucione lokale.

Përveç krijimit të një faqeje në Facebook dhe Twitter për të ngritur nivelin e vetëdijes publike, anëtarë të grupit kryen hulumtime mbi përfaqësimin gjinor në të gjitha strukturat udhëheqëse të nivelit komunal, përfshirë kryetarët e komunave, zëvendëskryetarët, kryesuesit e kuvendeve komunale, drejtorët e drejtorive dhe anëtarët e komisioneve të përhershme të kuvendeve komunale.

“Ne kryem hulumtime në të gjitha komunat e Kosovës në bazë të informatave në faqet e tyre në internet. Pothuajse gjysma e tyre nuk ishin fare të azhurnuara me këto të dhëna. Prandaj, ne i vizituam vetë disa prej këtyre komunave ndërsa nga disa të tjera informatat i morëm nga zyrat përkatëse për informim publik,” tha Bllaca. Herolind Rama, një tjetër anëtar i nismës thotë se hulumtimet janë kryer përgjatë disa muajsh dhe grupi ka qenë i pakënaqur me rezultatet e tij.

“Përqindja e përfaqësimit të grave në nivel lokal nuk është mjaftueshëm i lartë,” tha ai. Duke parë këtë situatë, ne kemi vizituar disa deputetë, përfshirë Lutfi Hazirin, Alma Lamën, Jeton Svircën dhe Teuta Sahatqinë, të cilët na premtuan se kjo klimë e përfaqësimit gjinor do të adresohet në listat e ardhshme zgjedhore.”



**PËRFAQËSIM TË DREJTË PËR
GJYSMËN E POPULLATËS**

Megjithatë, sipas këtij grupi, hulumtimet kanë zbuluar se situata ishte e rëndë; një nga gjetjet kryesore të tij ishte se disa komuna kishin shkelur Ligjin për Barazi Gjinore nga disa herë, duke përfshirë gratë në komisione të kuvendeve të tyre në normë më të ulët se 40%.

"Këto shkelje nënkuptojnë se komunat nuk janë duke u dhënë hapësirë të mjaftueshme dhe pozita përkatëse grave në procese vendimmarrëse," tha Bllaca. "Ndërsa situata është e njëjtë në të gjitha komunat."

Gjetjet kryesore ishin se në kuvendet komunale të Drenasit, Fushë Kosovës, Graçanicës, Mitrovicës së Veriut, Pejës dhe Skenderajt anëtarët e kuvendeve komunale përbënin më pak se 30 për qind të pjesëtarëve të tyre, gjë që përbën shkelje të Ligjit për Barazi Gjinore. Shkelje tjera të identifikuar ishin mes tjerash:

- Nga 38 kryetarë komunash, vetëm një është femër;
- Nga 39 nënkryetarë komunash, asnjë nuk është femër;
- Nga 38 kryesues të kuvendeve komunale, vetëm dy janë femra;
- Në 11 komuna nuk ka asnjë drejtoreshë të drejtorive komunale; dhe
- Në 5 komuna nuk ka asnjë anëtare të komisioneve të përhershme të kuvendeve komunale.

"Ishte jashtëzakonisht e rëndësishme që këto statistika të bëhen publike në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar dhe të fillojnë të ngrisin këtë çështje për diskutim në mënyrë që të mund të përmirësohet situata," tha Bllaca. "Nëse popullata është e balancuar në aspekt gjinor, me atë që 50 për qind janë meshkuj e 50 për qind femra, ne duhet të kemi edhe qeverisje të balancuar."

Nisma i bëri gjetjet e veta publike përmes debateve televizive, mediave tradicionale dhe veçanërisht përmes mediave sociale. Kjo nismë gjithashtu u bëri presion komunave që të ngrisin përfaqësimin e grave në komuna.

"Mendoj se një pjesë e qëllimit tonë, i cili ishte ta informojmë popullatën e Kosovës lidhur me nivelin e përfaqësimit në nivel lokal, u arrit," tha Bllaca. "Por nevojitet më shumë kohë për ta përmirësuar këtë pabarazi. Disa gjëra nuk mund të ndryshojnë brenda natës, ndërsa partitë politike nuk janë duke u ofruar grave hapësirë të mjaftueshme për të marrë pozita udhëheqëse në nivel kombëtar, të cilat do të nxitnin të njëjtën gjë edhe në nivel lokal."

Në anën tjetër, Herolind Rama mendon se është evidente që gjërat po ndryshojnë. "Situata paksa është përmirësuar por ende mbetet e pakënaqshme në kuptim të pritjeve tona," tha ai. Sidoqoftë, ne vazhdojmë të shprehim se në të ardhmen e afërt, përfaqësimi i grave do të vazhdojë të përmirësohet sepse kjo do të përbëjë dëshmi të demokracisë sonë të brendshme. Deri atëherë, ne nuk do të rreshtim së kërkuari realizimin e këtij qëllimi."

Nisma beson se sigurimi i balancit gjinor në kuvende komunale është tejte i rëndësishëm për pasqyrimin dhe përfaqësimin më të mirë të popullatës në to. Nisma tha se do të vazhdojë të punojë deri në arritjen e cakut të vet, që është përfaqësimi i barabartë gjinor.

Anëtarët e nismës:

Saranda Bllaca, Herolind Rama, Edona Thaçi, Gent Jusufi, Dardan Rama





 /kosovabike

Për shumë kosovarë të rinj, ngasja e biçikletës në qytet ka qenë pothuajse e pamundur. Në kryeqytetin e Kosovës janë fare të paktë shiritat e çiklizmit – shtigjet e veçanta të ndara për biçikleta. Ngarkesa e trafikut dhe mbishfrytëzimi i rrugëve të qytetit është i lartë, e edhe nëse shtigjet e çiklizmit përbëjnë zgjidhje më të sigurt, nuk është bërë shumë për të përmirësuar situatën në këtë drejtim gjatë dekadës së fundit.

Një grup i të rinjve që ka marrë pjesë në Shkollën për Media të Reja të NDI-së dëshironte të ulë rrezikun që ndërlidhet me ngasjen e biçikletës në qytet. Ideja fillestare e këtij grupi ishte që të shfrytëzojë mediat sociale për të ngritur vetëdijen lidhur me përfitimet që qytetarët dhe institucionet e Kosovës mund t'i nxjerrjen nga çiklizmi.

"Unë dëshiroja të avokoj për këtë, pasi që edhe vet jam entuziast i çiklizmit dhe

sporteve," thotë Genc Jaha, anëtar i kësaj nisme. "Ideja ishte që të ndërtohen shtigje të çiklizmit në komuna që kanë terrenin më të përshtatshëm për këtë qëllim, në mënyrë që të mund [ta zvogëlojmë ndotjen nga veturat dhe] tu ndihmojmë qytetarëve që të jetojnë në një mjedis më të pastër."

Nisma ka vendosur që të avokojë pranë institucioneve lokale në komunat Ferizaj, Gjakova, Gjiilan, dhe Mitrovica për ndërtimin e shtigjeve të çiklizmit në rrugët ekzistuese dhe të planifikojnë përfshirjen e shtigjeve të tilla në të gjitha projektet infrastrukturore.

"Ne deshëm të sigurohemi që nëse propozimi jonë nuk miratohet, këto komuna së paku të planifikojnë vendosjen e shtigjeve të çiklizmit në të ardhmen e afërt, thotë Jaha. Ne i përzgjedhëm këto komuna për shkak të gjeografisë së përshtatshme për këtë qëllim, prandaj ne e dinim se në to mund të ndërtohen shtigje çiklizmi.



KOSOVA BIKE

Anëtarët e nismës hartuan një argument njëfaqësh të cilin ia paraqitën departamenteve të infrastrukturës së komunave të lartpërmendura. Nisma thoshte se miratimi i politikave të reja për krijimin e shtigjeve të çiklizmit është i rëndësishëm së madhe për komunat, pasi që do të ndikojë pozitivisht në mjedis, zvogëlon trafikun në rrugë të ngarkuara dhe i kontribuon përfitimeve publik.

Nisma u takua me Drejtorin e Drejtorisë së Urbanizimit në Mitrovicë për t'ia paraqitur idenë e krijimit të shtigjeve të çiklizmit. Drejtori i tha nismës se ajo përbënte grupin e parë që po avokonte për shtigje çiklizmi dhe u tregua i gatshëm për të filluar së punuari në ndarjen e shtigjeve në fjalë në rrugët kryesore të Mitrovicës.

Pas takimit me zyrtarë të komunës së Gjilanit, nisma kuptoi se shtigjet e çiklizmit ishin në proces të ndarjes në rrugët kryesore të Gjilanit. Nisma tanimë vazhdoi me bisedime me Drejtorinë e Urbanizimit të Ferizajit, e cila premtoi ndërtimin e shtigjeve të para të çiklizmit në Ferizaj, ndërsa tani planifikon që të bindë edhe Gjakovën që miratojë politika të ngjashme. Genta Domi, anëtare e nismës, thotë se është tejet e rëndësishme që komunat të miratojnë propozime me të cilat ofrohet siguri për çiklistët. "Miratimi i rekomandimeve tona është jetike për komunat, sepse është e domosdoshme që çiklistët të kenë shtigjet e veta nëse duam t'i shmangin aksidentet të cilat janë bërë gjë e zakonshme ditëve të sotme," tha ajo.



Nisma thotë se deri tani caqet e veta janë duke u realizuar, për shkak se komunat veç kanë filluar të krijojnë shtigje për këmbësorë në projektet e tyre infrastrukturore. "Në të ardhmen e afërt, ne planifikojmë të takohemi me komunat tjera për të avokuar për qëllimin tonë dhe për të parë se çfarë kanë ndërmarrë komunat që janë zotuar se do të ndërtojnë shtigje për çiklistë," tha Domi.

Anëtarët e nismës:

Fixhirije Dragaj, Dhuratë Ukshini,
Genci Jaha, Genc Mustafa, Shkumbin Nebihu,
Kujtim Bajrami, Genta Domi



Integrimi i korsive për biçikleta në planifikimin urban në pesë Komuna



Kuvendet Komunale të Prishtinës, Ferizajit, Gjilanit, Mitrovicës dhe Gjakovës të marrin vendime për të bërë të obligueshme ndërtimin e korsive për biçikleta në projektet infrastrukturore në të ardhmen



Gjetja e mbështetjes online dhe në Komuna



Paraqitja e propozimit pranë Qeverisjes Komunale dhe Këshilltarëve Komunal



Ky projekt-propozim u miratua në Ferizaj dhe Mitrovicë



Edhe pse Ligji për Kontrollin e Duhanit në Kosovë e ndalon pirjen e duhanit në të gjitha hapësirat e mbyllura publike, ai shpesh nuk zbatohet dhe nuk respektohet në kafene dhe restorante. Të pakënaqur me këtë situatë të krijuar, Selvije Kurti dhe katër të rinj tjerë vendosën që të ndërmarrin diçka lidhur me çështjen.

“Marrë parasysh pasojat e pirjes së duhanit, unë jam shumë kundër këtij vesi të keq, i cili shpesh është edhe vdekjeprurës,” thotë Kurti. “Përveç kësaj, masa deri në të cilën normat ligjore dhe shoqërore respektohen dhe implementohen veçse pasqyrojnë nivelin e gatishmërisë së vendit për të pasur një shoqëri të shëndoshë. Prandaj, unë desha t’i kontribuoj një shoqërie që vë në rend të parë mirëqenien e qytetarëve të vet.”

Në vitin 2013, Kurti dhe katër tjerë pjesëmarrës themeluan nismën “Mos e dhez”, si pjesë të Shkollës së Mediave të Reja të NDI. Qëllimi i kësaj nisme ishte të avokojë për zbatim më të mirë të Ligjit për Kontrollin e Duhanit. Duke shfrytëzuar kanale të mediave sociale, kjo nismë u angazhua dhe i informoi qytetarët mbi rëndësinë e këtij ligji dhe kreu hulumtime të opinionit publik të cilat shërbyen si bazë për avokimin e saj.

“Pasi që një nga qëllimet tona kryesore ishte sigurimi i presionit publik për të respektuar Ligjin për Kontrollin e Duhanit, ne duhej të kishim një pasqyrë të qartë të pengesave ndaj zbatimit të tij,” na tha Kastriot Muçolli, një tjetër anëtar i kësaj nisme. “Ne vendosëm që respondentëve t’ua parashitrojmë disa pyetje lidhur me atë se sa respektohet Ligji për Kontrollin e Duhanit dhe cilët janë shkelësit më të mëdhenj të tij.”

Grupi kuptoi përmes kësaj ankete se 85% të respondentëve të saj nuk besojnë se Ligji për Kontrollin e Duhanit po respektohej, ndërsa 64% kurrë nuk kishin raportuar ndonjë shkelje të vërejtur të këtij ligji. Sipas respondentëve të anketës, pas kafeneve dhe klubeve, shkeljet më të shpeshta të ligjit ngjani në ndërtesa qeveritare dhe në kuvend.

Në bazë të këtyre të gjeturave, nisma hartoi një listë rekomandimesh, mes cilave shqiptimi i masave më të rrepta ndëshkuese për shkelësit e ligjit në formë të gjobave më të larta, realizimi i fushatave vetëdijesuese nëpër shkolla dhe universitete, si dhe monitorimi i inspektorëve të këtij ligji të cilët thuhej se rrallë dënonin pronarët e kafeneve me të cilët ndesheshin. Në vitin 2016, tri vite pas hyrjes së këtij ligji në fuqi, nisma





organizoi një konferencë përmes së cilës lansoi platformën e vet online për raportimin e shkeljeve të Ligjit për Kontroll të Duhanit, edhe të një ditë para Ditës Ndërkombëtare Kundër Duhanit. Kjo platformë iu vu në dispozicion të gjithë atyre që duan t'i qasen dhe raportojnë shkelje të ligjit.

“Ngjarja në të cilën ne zbuluam gjetjet tona dhe lansuam platformën online shkoi ashtu siç e kishim planifikuar,” thotë Muçolli. “Kishte mbulim të mirë nga mediat, të cilat na ndihmuan në promovimin e platformës dhe në shtimin e numrit të raportimeve të shkeljeve.”

Pas lansimit të kësaj ngjarjeje, zyrtarë të lartë, përfshirë Ministrin e Shëndetësisë ImetRrahmani dhe Kryesuesen e Komisionit për Shëndet, Punë dhe Mirëqenie Sociale Flora Brovina, shprehën brengën e tyre për faktin se vendet ku ligjet miratoheshin ishin në mesin e vendeve në të cilat ligjet më së paku respektohen. Për më tepër, ata kërkuan që vendi të zhvillojë një kulturë më të mirë të shëndetit. Për të bërë këtë, të dy zyrtarët u pajtuan se implementimi i këtij ligji duhet të jetë në fokus.

Kjo nismë tha se do të vazhdojë të bëjë hapësirat publike vende në Kosovë vende më të shëndetshme për të gjithë. “Ne konsiderojmë se kjo nismë ka qenë e guximshme dhe një nga të parat që ka ngritur nivelin e diskutimit lidhur me këtë çështje e cila shpesh është lënë pas dore nga vetë institucionet relevante,” tha Kurti. “Ne mëtojmë të ngrisim zërin kundër shkelësve të ligjit dhe të monitorojmë zbatimin e tij. Ka edhe shumëçka tjetër për tu bërë, por ne jemi të zotuar që të arrijmë misionin e nismës sonë.”

Platforma për raportimin e shkeljeve të Ligjit për Kontrollin e Duhanit mund të qaset në faqen: www.mosedhez.com

Anëtarët e nismës:

Kastriot Muçolli, Selvije Kurti, Labinot Beqa, Ilirjana Perteshoni (U prehtë në paqe), Ramadan Mramori, Ilirjana Dukaj





 /Ruaje-tënden

Kryeqyteti i Kosovës, Prishtina, ka ekzistuar si qytezë e vogël që nga shekulli IX. Si vendbanim shekullor, Prishtina ka trashëguar artefakte të shumta kulturore, arkeologjike dhe arkitektonike, shumë prej të cilave janë shkatërruar gjatë regjimit komunist në Kosovë. Pazari i vjetër i Kosovës, i konsideruar si njëri nga më të bukurit e Evropës juglindore, u shkatërrua pas luftës së dytë botërore, duke lënë prapa vetëm disa objekte si hamami i vjetër 600-vjeçar.

Pas shumë vitesh neglizhencë nga autoritetet, Komuna e Prishtinës u përpoq që ta restaurojë hamamin në vitin 2006, por renovimet e kryera nga persona që nuk ishin ekspertë, e dëmtuan autenticitetin e ndërtesës. Në vitin 2015, një grup të rinjsh që morën pjesë në Shkollën e Mediave të Reja të NDI-së formuan nismën "Ruaje Tënden", për të avokuar për mbrojtjen e hamamit dhe ngritjen e vetëdijes lidhur me këtë çështje në media sociale.

"Pasi që dëgjuaam për nivelin e lartë të degradimit të hamamit, në momentin që grupi u bë bashkë ne e dinim se kjo është çështja për të cilën duam të avokojmë dhe se ne duhet të mbronim këtë monument të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore," tha Donjetë Ahmetaj, anëtare e nismës.

Pas kryerjes së hulumtimeve në teren, takimit me zyrtarë të Ministrisë së Kulturës dhe organizata që merren me trashëgiminë kulturore, siç është Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHWB), nisma filloi me hartimin e një raporti të hulumtimit. Gjetjet konfirmuan se hamami po shkatërrkohej.

"Ne filluam punën duke e vizituar hamamin si grup për të konfirmuar atë që kishim dëgjuar nga shumë njerëz më parë lidhur me gjendjen e tij. Zyrtarët nga Departamenti i Kulturës na njoftuan se çka ishte bërë deri tash dhe sa kishin kushtuar punët e deritashme," tha Ahmetaj. "Drejtori Ekzekutiv i Këshillit Kosovar për Trashëgimi Kulturore dhe organizata CHWB gjithashtu ndanë me ne informata të shumta lidhur me hulumtimin e tyre, nga të cilat e kuptuam se pjesa më e madhe e dëmit ishte bërë gjatë restaurimit të objektit.

Hulumtimi i nismës ka zbuluar se problemet kanë filluar me fazën e dytë të projektit në vitin 2009. Problemi së pari u shfaq kur kompania e kontraktuar për restaurim, sipas CHWB, nuk kishte përvojën e duhur për të ruajtur dhe restauruar hamamin, ndërsa punët i kryente jo në pajtim me planin. Pa marrë parasysh kritikën nga ekspertët, punët në restaurim vazhduan



RUAJE TËNDEN

deri në vitin 2013 kur Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit vendosi që të ndërpresë projektin.

“Përfundimi i hulumtimit tonë ishte detyrë e lehtë,” that Fatir Berzati, anëtar i nismës. “Hapat tjerë ishin ngritja e vetëdijes se si të jemi sa më aktiv që është e mundur deri sa të merrnim vendimin e Ministrisë së Kulturës.”

Grupi iu përvesh punës me media sociale me qëllim të ngritjes së vetëdijes publike dhe kërkimit të veprimeve parandaluese nga qeveria. Nisma thoshte se trashëgimia kulturore ishte burim vital i identitetit kombëtar, që lidhë të kaluarën me të tashmen, dhe kërkonte nga të rinj e të vjetër të mbrojnë trashëgimin e Kosovës dhe të raportojnë dëmtimin e monumenteve të rëndësishme.

Rrjedhimisht, në prill të vitit 2016, Ruaje Tënden e organizoi një takim me Komisionin për Kulturë të Kuvendit të Kosovës, në të cilin paraqiti gjetjet e veta dhe kërkoi veprim të menjëhershëm për të mbrojtur hamamin nga dëmtimi i mëtejshëm.

“Fakti që hamami u shfaq në media – TV dhe shtyp, dhe para kuvendit, përbën sukses në veti,” thotë Berzati. “Ne biseduam për hulumtimin tonë, për dëmin që i është bërë hamamit nga kompanitë e kontraktuara më parë, ndërsa deputetët e Komisionit për Kulturë e përkrahën nismën tonë duke na siguruar se puna jonë ishte e rëndësishme për shoqërinë e Kosovës.”

Nisma paraqiti një listë të hapave të rekomanduar për tu ndërmarrë, që përfshinte paraqitjen publike të raportit të hartuar nga ekspertët me të cilin vlerësohen restaurimi; krijimin e një komisioni ekspertësh për të vlerësuar si duhet të procedohet me restaurim; dhe hartimin e menjëhershëm të një plani të ri për ruajtjen dhe restaurimin e hamamit.



Komiteti i Kuvendit për Kulturë zyrtarisht kërkoi nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe Ministria e Kulturës të ndërmarrin veprime të menjëhershme për të parandaluar degradimin e mëtejshëm të Hamamit të Madh të Prishtinës.

“Ne po vazhdojmë të presim masat konkrete që duhet të ndërmerren për të ruajtur lokacionin, prandaj deri atëherë unë nuk mund të them se objektivat tona janë arritur,” thotë Ahmetaj. “Ka përfunduar vetëm ‘faza ekzekutive’ – paraqitja e problemit në nivel të kuvendit dhe rikujtimi i liderëve tanë se çfarë duhet të bëhet; tani duket të kalojmë në avokim tek njerëzit për ta ngritur nivelin e presionit.”

Anëtarët e nismës:

Donjetë Ahmetaj, Fatir Berzati,
Bestrim Alijaj, Besfort Gashi,
Rexhep Avdo, Fahri Jashari




Ruajtja dhe mbrojtja e Hamamit 600 vjeçar të Prishtinës



Çështja është ngritur në Kuvend, Qeveri dhe në Këshillin e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës



Gjetja e mbështetjes në media sociale dhe tradicionale



Qeveria e merr në mbrojtje dhe restauron dëmet



Ministria e Kulturës dhe Komuna e Prishtinës marrin vendim për ruajtjen dhe mbrojtjen e Hamamit të Prishtinës



f /rritushnetshem

Konsumi i pijeve energjike në Kosovë është në rritje. Pijet energjike janë në dispozicion gjithandej: në kafene, klube, supermarkete e madje edhe në rrugë. Oferta e gjerë për pije të tilla nuk është e rastësishme, ngase ka kërkesë të madhe për to edhe nga të rriturit edhe nga fëmijët.

Kjo kërkesë kryesisht i atribuohet faktit që pijet energjike premtojnë rritje të nivelit të energjisë, që në fakt është zgjidhje e përkohshme si rezultat i përmbajtjes së rritur të kafeinës dhe sheqerit në to. Por, përbërësit si taurina, kafeina, guarana dhe kreatina të cilat shpesh gjenden në këto pije janë skajshmërisht të dëmshme, në veçanti kur nuk i nënshtrohen rregullimit, ndërsa për fëmijët përbëjnë rrezik të posaçëm.

Duke e parë që shumë njerëz nuk janë në dijeni për implikimet shëndetësore të konsumit të pijeve energjike, një grup që vijonte Shkollën e Mediave të Reja të NDI-së themeloi nismën "Rritu Shnetshëm", me qëllim të ngritjes së vetëdijes lidhur me efektet negative të pijeve energjike tek fëmijët dhe avokimit për ndalimin e shitjes së tyre për fëmijë.

"Kur vendosëm ta trajtojmë këtë çështje, ne kishim në dispozicion vetëm informata

bazike lidhur me atë se çfarë u bëjnë fëmijëve pijet energjike, e edhe ato ishin mjaft brengosëse për ne," tha Afrim Berisha, një nga anëtarët e nismës. "Ne ishim të bindur se mund ta përmirësojmë këtë situatë duke bashkëpunuar me institucionet."

Nisma e hapi një faqe në Facebook dhe Twitter, postonte rregullisht mbi rreziqet që ndërlidhen me shëndetin e të cilat i paraqesin pijet energjike. Nisma gjithashtu anketoj mbi 1,000 fëmijë dhe prindër të Kosovës mbi nivelin e konsumit të pijeve energjetike nga ta. Grupi kuptoi se 74 për qind të respondentëve fëmijë konsumonin pije energjike çdo javë, ndërsa 85 për qind të prindërve pajtoheshin se qeveria duhet të kufizojë shitjen dhe konsumin e pijeve energjike për fëmijë nën moshën 18-vjeçare.

"Gjetet kryesore që i zbuluam përmes anketës ishin se pijet energjike konsumoheshin shumë dhe se fëmijët ishin fare pak të vetëdijshëm se sa të rrezikshme ato pije mund të jenë për shëndetin e tyre," tha Berisha. "Prandaj ne vendosëm që të avokojmë për organizimin e fushatave vetëdijesuese në shkolla fillore të Kosovës lidhur me ndikimet e pijeve energjike në shëndetin e fëmijëve."





Nisma gjithashtu hulumtoi se cilat ishin praktikat ndërkombëtare dhe kornizat ligjore që rregullonin pijet energjike, si dhe u konsultuan me nutricionistë të vendit. Ajo analizoi Hungarinë, Letoninë, Lituaninë, Meksikën dhe Suedinë, si shembuj të vendeve që ose kanë miratuar ligje që parandalojnë shitjen e pijeve energjike për fëmijët, ose u kanë vendosur kompanive që shesin pije të tilla restriksione të fuqishme.

“Ne pamë përvojat e vendeve tjera dhe e kuptuam se nuk jemi të parët që merremi me këtë çështje,” tha Berisha. “Ne duam ta bëjmë të qartë se nuk jemi duke kërkuar ndonjë ndryshim të jashtëzakonshëm dhe se ka shumë vende të cilat e kanë kufizuar konsumimin dhe shitjen e këtyre pijeve për shkak të rreziqeve për shëndetin, shumë para nesh. Ne kemi marrë praktikat më të mira nga këto vende dhe i kemi inkorporuar ato në hulumtimin tonë.”

Kjo nismë ka kërkuar nga institucionet shtetërore të miratojnë ligjet e duhura dhe të zbatojnë obligimin e vendosjes së

etiketave paralajmëruese mbi rrezikun shëndetësor që vjen nga pijet energjike, si dhe takime me Komisionin e Kuvendit të Kosovës për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Arben Imeri, një tjetër anëtar i kësaj nisme, tha se ata kanë organizuar takimin me Komisionin për t’ia sqaruar të njëjtit seriozitetin e efekteve shëndetësore që shkaktohen nga konsumi i tepruar i pijeve energjike nga fëmijët. “Komisioni mirëpriti hulumtimin dhe rekomandimet tona, duke thënë se do të kërkojnë adresimin e problemeve me të cilat fëmijët përballen në kuptim të konsumit të pijeve energjike,” tha Imeri.

Komisioni u pajtua që të rishikojë kornizën ligjore dhe propozojë amendamente për të adresuar rekomandimet e nismës.

“Mendoj se objektivat afatshkurtra janë arritur; ne kemi përgatitur hulumtimin në këtë temë, kemi marrë pjesë në programe televizive për të ngritur vetëdijen mbi këtë çështje dhe i kemi paraqitur të gjitha rekomandimet tona para një organi legjislativ,” tha Imeri. Sa i përket caqeve tona afatgjata, ne jemi optimistë dhe nisma do të vazhdojë të punojë në adresimin e brengave që ndërlidhen me pijet energjike.”

Anëtarët e nismës:

Blerinë Ukshini, Linda Shahini, Afrim Berisha, Arben Imeri, Valentina Gërzhaliu, Aldisa Morina, Ismail Halili





f /Shpëto-Shpellën

Shpella e mermerit Gadime në Lipjan, Kosovë, është fenomen i bukur natyror dhe një nga atraksionet më të vizituara në Kosovë. Muret e saj të ulëta harkore përfaqësojnë një larmi të jashtëzakonshme të stalaktiteve, stalagmiteve dhe aragoniteve. Shpella u zbulua në fund të viteve 1970-ta dhe ka qenë vend i rëndësishëm gjeologjik që kur u hap për vizitorë. Megjithatë, viteve të fundit shpella u dëmtuar dhe degradua rëndë nga keqmenaxhimi, dhe kishte nevojë urgjente për ruajtje të duhur.

Në vitin 2013, një grup i të rinjve vendosi që të bëjë diçka në lidhje me përkeqësimin e shpellës. Së bashku me katër kolegët të saj nga Shkolla e Re Mediale e NDI, Erina Rrahmani krijoi nismën "Ruaje Shpellën" për ta kthyer vëmendjen tek shpella frymëzuese, dëmet e shkaktuara tek ajo si pasojë e keqmenaxhimit, si dhe nevoja e menjëhershme për ruajtjen e saj. "Objektivat tona kryesore kanë qenë informimi i publikut se Shpella e Gadimes ishte në një gjendje të mjerueshme dhe këtë e kemi bërë përmes faqes sonë në Facebook dhe storieve në lajmet lokale", tha Rrahmani.

Pas konsultimit me ekspertë nga Sllovenia, grupi arriti në përfundim se shkatërrimi i shpellës ishte më serioz se që mendonin. Një raport i detajuar dokumentoi se dritat artificiale kishin ndryshuar temperaturën e shpellës, dhe se rezervuari i ujit i ndërtuar mbi shpellë nga komuna e Lipjanit ishte gjithashtu duke e dëmtuar atë. Në përgjithësi, raporti vlerësoi menaxhimin e karakteristikave të shpellës si të dobët.

Nisma synoi që ta kalojë menaxhimin e shpellës tek qeveria e Kosovës, duke e rinovuar dhe investuar në të për ta bërë atraktive për turistë. "Të gjithë anëtarët e grupit kishin vullnet që përmes kësaj nisme të sjellin ndryshim," shpjegoi Rrahmani. "Ishte ky qëllim i përbashkët që na nxiti të bëhemi miq."

Pasi grupi e prezantoi nismën te ta, një grup i anëtarëve të opozitës në kuvend e lexuan deklaratën e grupit në një seancë plenare të Kuvendit të Kosovës dhe kërkuan llogaridhënie nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) në lidhje me gjendjen e rëndë të shpellës.

Save the Cave - Shpëto Shpellën

SHPËTO SHPELLËN



Si rezultat i përpjekjeve të fushatës, MMPH mori masa për të krijuar një njësi të veçantë për menaxhimin dhe ruajtjen e shpellës. Ministria gjithashtu e shpalli shpellën zonë të mbrojtur kombëtare.

“Sot unë jam shumë e lumtur që e gjithë kjo është arritur falë nismës sonë”, tha Rrahmani. “Unë nuk do të mund të isha më e lumtur për gjendjen në të cilën është në sot shpella. Gjërat më të mira janë momentet kur njerëzit nga jashtë janë të mahnitur nga bukuria e shpellës, por edhe momentet kur njerëz që i njoh na përgëzojnë për punën e bërë nga nisma jonë”.


Kërkesa e nismës për menaxhim të legalizuar dhe formalizuar të shpellës në kuadër të institucioneve shtetërore rezul-

toi me përmirësuar administrimin të përgjithshëm dhe menaxhimin të duhur të tëhyrave nga biletat. MMPH dhe Ambasada Franceze në Prishtinë kanë ndërmarrë veprime të përbashkëta për ruajtjen dhe restaurimin e saj. Janë instaluar ndriçime më eko-miqësore, menaxhimi i shpellës është rritur me punonjës shtesë, duke përfshirë katër ciceronë zyrtarë, si dhe numri i vizitorëve është rritur, me 70,000 vetëm në vitin 2015.

Sot shpella është zonë e mbrojtur dhe do të mbetet trashëgim për gjenerata të ardhshme.

Anëtarët e nismës:

Erina Rrahmani, Rezarta Delibashzade,
Fillojetë Konjuhi, Petrit Beqiri, Xhevat Dervishi





Sistemi arsimor i Kosovës përfshin sektorin joformal të njohur si “shkollat e mbrëmjes”, që është kryesisht i parregulluar, i përmblytur në korrupsion, dhe konsiderohet formë joefikase e shkollimit. Disa shkolla nuk kanë licenca për realizimin e programeve arsimore; në raste të tjera, studentët thjeshtë paguajnë që të marrin një diplomë pa vijuar ligjëratat.

Pasi dëgjua për problemet e shumta me arsimin joformal, një grup grash nga shoqëria civile dhe partitë politike të cilat morën pjesë në Akademinë e Grave për Leadership, themeluan një nismë avokuese të quajtur “Kundër korrupsionit në arsim”. Grupi punon drejt përmirësimit të fushës së arsimit si pjesë përbërëse e promovimit të zhvillimit shoqëror në shtetin më të ri të Ballkanit.

Përderisa Kosova ka legjislacion të fortë për arsimin, zbatimi i tij është problematik, prandaj kjo nismë synon që të sigurojë zbatim të ligjit për arsimin dhe aftësimin e të rriturve, veçanërisht duke u fokusuar në rregullimin e arsimit joformal në Kosovë.

“Takimet e para i kemi mbajtur në shkollat profesionale që ofronin arsim joformal, dhe ata shprehen shumë pakënaqësi me mënyrën se si është menaxhuar procesi deri tani”, tha anëtarja e nismës Vjollca Shyti. “Por edhe në fillim, ishte e qartë se takimet tona kishin ndikim, dhe inspektorët e arsimit në Gjakovë na thanë se pas takimit tonë, shkolla profesionale kërkoi licencë për aplikimin e arsimit joformal.”

Nisma vazhdoi për të kryejë hulumtime në tri komuna për të shqyrtuar nivelin e shkeljeve të procedurave të arsimit joformal. Hulumtimi është kryer në Gjakovë, Malishevë dhe Pejë, tri komuna që kanë licencën e duhur të shtetit për të aplikuar arsimi joformal në shkolla. “Ajo që kemi konstatuar është se ka pasur pakënaqësi të madhe me cilësinë e mësimdhënies në arsimin joformal,” komentoi Shyti. Gjetjet e nismës forcuan idenë se keqsjellja dhe mungesa e transparencës mbi mënyrën se si realizohen pagesat janë të zakonshme në arsimin joformal. Përveç kësaj, grupi ka gjetur se orët po mbahen në shkollat që nuk janë të licencuara; studentët nuk plotësonin



KUNDËR KORRUPSIONIT NË ARSIM

numrin e orëve të nevojshme për të marrë diplomë të shkollës së mesme - ku shumica paraqiteshin vetëm për provimin përfundimtar; si dhe ka pasur mungesë të mbikëqyrjes së materialit mësimor në këto shkolla joformale.

Nisma, së bashku me NDI, organizoi takime zyrtare në tri komunat pas hulumtimit fillestar për t'u takuar me drejtorët e arsimit dhe drejtorët e shkollave për të kërkuar qëndrimin e tyre zyrtar për përmirësimin e cilësisë së arsimit joformal. "Drejtorët e arsimit kishin gatishmëri për bashkëpunuar me ne dhe ofruan mbështetjen e tyre," tha Shyti. "Ata gjithashtu na thanë se e kanë përcjellë informatën lidhur me problemet me arsimin joformal tek Ministria e Arsimit, por asgjë nuk është arritur deri më tani; ndryshimi nuk është i lehtë."

Drejtori i Arsimit dhe Inspektori i Arsimit në Komunën e Pejës ka specifikuar se një nga arsyt pse arsimi joformal nuk është përmirësuar me kalimin e viteve është sepse nuk ka asnjë proces adekuat monitorimi si pasojë e numrit të vogël të inspektorëve të arsimit. Janë vetëm katër inspektorë të cilët mbulojnë rajonin e Pejës dhe janë përgjegjëse për inspektimin e shkollave fillore, të mesme dhe universiteteve.

Shyti u takua edhe me Inspektorin e Arsimit në komunën e Gjakovës, Zef Osmanin, i cili iu pajtua se procesi i arsimit joformal ka shumë mangësi, të cilat duhet përmirësuar. Zyra e Inspektoratit të Gjakovës pastaj dërgoi një rekomandim tek kryetarët e Gjakovës, Malishevës dhe Rahovecit, si dhe drejtorët për arsim të komunave, që menjëherë të hartojnë rregulloret e shkollës në lidhje me kriteret për pagesën e kandidatëve për provime, riprovime dhe diploma. Zyra e

Inspektoratit kërkoi që të gjitha shkollat të respektojnë ligjet dhe rregulloret për organizimin e provimeve.

Dy vjet pas fillimit, kjo nismë ka shënuar progres në trajtimin e problemeve që kanë prekur arsimin joformal në Kosovë. Përmes punës së saj, nisma ka ndërruar sjelljen institucionale për të ndarë më shumë kohë dhe burime për arsim joformal.

"Si pasojë e mbështetjes së NDI, përpjekjet tona kanë qenë të suksesshme në fund, por kjo nuk mjafton; kemi ende shumë për të bërë," tha Shyti. "Unë mendoj se i takon Ministrisë që të krijojë mekanizma për të përmirësuar mangësitë e arsimit joformal të theksuara nga hulumtimet tona. Ne jemi të vetëdijshëm se sistemi arsimor në Kosovë nuk është i përsosur, kështu që grupi ynë është duke bërë plane për takime me zyrtarët e Ministrisë së Arsimit."

Duke filluar në shtator 2016, nisma, bashkë me drejtorin dhe inspektorin e arsimit në Komunën e Gjakovës, filloi realizimin e një projekti për monitorimin e procesit të rekrutimit të studentëve dhe profesorëve në shkollat ku aplikohet arsimi joformal. Nisma do të vazhdojë të punojë drejt arritjes së qëllimeve afatgjate në këtë fushë.

Anëtarët e nismës:

Drenusha Mula, Mevlyde Idrizi,
Qendresa Kastrati Hoxha, Vjollca Shyti





Nuk është vështirë të takosh një banor të Prishtinës që ankohe për cilësinë e ajrit të qytetit. Ndotja e ajrit është kryesisht rezultat i termocentraleve me qymyr që gjenden pesë kilometra afër qytetit. Krahas deponimit të parregulluar të mbeturinave dhe ujit të papastre, ndotja e ajrit është problem i rëndë mjedisor që Kosova duhet ta zgjidhë. Korniza ligjore e Kosovës rregullon mbledhjen e taksës rrugore dhe ekologjike dhe, në letër, këto taksa duhet të shkojnë në investime për mjedis. Në realitet, fondet e grumbulluara shkojnë në buxhetin e përgjithshëm shtetëror, pa ndarje të qarta buxhetore për mbrojtje të mjedisit.

Të zemëruar me degradimin e mjedisit të Kosovës Burbuqe Bakija Deva dhe pesë pjesëmarrëse të tjera të Akademisë së Liderimit të Grave të NDI-së formuan nismën "EKOSOVA", e cila ka për qëllim rritjen e investimeve të Kosovës në mjedis përmes zbatimit të ligjeve për taksat rrugore dhe ekologjike.

"Gjithmonë më ka penguar se ekziston një qasje që gratë duhet kryesisht të merren me çështje të grave, apo me gjëra që perceptohen si çështje të grave," tha Deva. "Gratë kanë shkathtësi dhe kapacitete të trajtojnë edhe probleme të tjera që prekin shoqërinë, dhe duke e parë se gjendja e mjedisit është e rëndë, dhe se ky problem nuk është vënë si prioritet për qeverinë, grupi ynë vendosi të merret me mjedisin."

Me qëllim që të ndriçojmë faktin se sa pak janë duke u zbatuar taksat rrugore dhe ekologjike, anëtarët e nismës "EKOSOVA" mbledhën dhe analizuan të dhëna për një periudhë prej tre muajsh. Anëtarët e nismës i ndanë detyrat e hulumtimit, i cili përfundimisht do të përpilohej në propozime të politikave. Ata gjetën se vetëm 0.7 për qind e buxhetit të Kosovës ndahet enkas për mjedisin, dhe se shqetësimet mjedisore janë ngritur nga deputetët vetëm nëntë herë gjatë vitit 2015. Përveç kësaj, investimet komunale në mjedis kryesisht shkojnë në investime infrastrukturore dhe shpeshherë përgjithësohen së tepërmi dhe shumë komuna nuk kanë zyrtarë që merren me mjedisin.

Ndryshe nga vëmendja e ulët e qeverisë në këtë çështje, në një anketë në internet, grupi gjeti se 74 për qind e respondentëve nuk ishin të kënaqur fare me gjendjen e mjedisit në



Kosovë. Për më tepër, kishte kuptim të ulët publik mbi taksën ekologjike: gjersa 73 për qind e respondentëve theksuan se kishin veturë dhe 70 për qind ishin në dijeni për taksën ekologjike, 52 për qind nuk e dinin qëllimin e saj.

“Unë isha përgjegjëse për hulumtimin mendimeve të stafit të Kuvendit, dhe në lagjen Kalabria [Prishtinë],” tha anëtarja e iniciativës Shpresa Gosalci. “Unë erdha në përfundim se shumica e njerëzve janë në dijeni se pse taksa mbledhet taksa ekologjike, por nuk e dinë nëse ato para shkojnë në drejtim të mjedisit.”

Duke dashur që të rrisim ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe institucioneve të Kosovës në lidhje me problemet mjedisore në vend, “EKOSOVA” organizoi një ekspozitë pikturash në ambientet e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ku u shfaqën punimet e nxënësve të shkollave të mesme dhe të larta lidhur me atë që ata shihnin në mjedisin e Kosovës. Pesëmbëdhjetë studentë patën mundësinë që t’i shprehin shqetësimet e tyre mjedisore përmes artit.

Bashkë me pikturat, u prezantuan rezultatet e hulumtimit në një dokument të politikave në diskutime në tryezë të rrumbullakët të mbajtur me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Tokës në Kuvendin e Kosovës, me anëtarët e Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Planifikim Hapësinor, deputetë; përfaqësues të qeverive lokale dhe qendrore, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Bazuar në gjetjet e saj, nisma propozoi rekomandime specifike për institucionet, që ndryshonin nga rritja e buxhetit të ndarë për mjedisin dhe krijimin e linjës buxhetore për subvencione në

kuadër të Ministrisë së Mjedisit, për të siguruar ser komunitat kanë zyrtarë që merren shprehimisht me mjedisin. Nisma gjithashtu bëri thirrje për rritje të qytetarisë aktive duke kërkuar llogaridhënie për shpenzime qeveritare në mjedis.


Nisma “EKOSOVA” hasi në mbështetje nga institucionet qeveritare. “Kurdoherë që donim të takohemi me dikë, posaçërisht për sa i përket hulumtimit tonë, veçanërisht në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe në Kuvend,” theksoi Gosalci.

Meqë çështjet mjedisore në Kosovë janë të rënda, nisma planifikon që të vazhdojë të punojë në këtë temë. “Fakti që projekti ynë i parë kapi vëmendjen e kaq shumë organizatave joqeveritare (OJQ-ve) na mbushë me energji që të vazhdojmë tutje” theksoi Deva. “Bashkëpunimi shembullor i anëtarëve, edhe pse të gjitha vinim nga prapavija të ndryshme politike, përforcoi edhe më shumë vullnetin tonë për të punuar tutje.”

Për disa anëtare, kjo nismë i ndihmoi që të përmbushin një ëndërr të kamotshme dhe ndonëse kanë rrugëtim të vështirë para vetes, ato janë të kënaqura me rezultatet e tyre deri më tani. “[Një nismë si] EKOSOVA është një nga dëshirat e mia që një kohë të gjatë, dhe dëshira jonë për t’u përfshirë pandërprerë në këtë aktivitet, shpresoj, do të më çojë në realizimin e synimit tonë kryesor: që EKOSOVATë bëhet OJQ për mbrojtjen e mjedisit,” tha Gosalci.

Anëtarët e nismës:

Burbuqe Bakija Deva, Blerinë Ukshini,
Esma Bunjaku, Krenare Sopjani,
Shpresa Gosalci, Shefkije Mehmeti, Vjollca Nagavci Roka





 /firstaidawareness

Popullsia rurale e Kosovës radhitet si lartë në mesin e vendeve të Ballkanit, me më shumë se 60 për qind të 1.9 milionë banorëve me banim në zona rurale.¹ Shumë njerëz që jetojnë në zona të largëta e të izoluar nuk kanë qasje në kujdes shëndetësor parësor, dhe liria e tyre e lëvizjes është tejet e kufizuar. Objektet e kujdesit shëndetësor primar janë shpeshherë me kilometra larg fshatrave. Pa transport të qëndrueshëm që lidh objektet shëndetësore me banorët, shumë njerëz në ato fshatra i drejtohen mjekësisë tradicionale, gjë që shpeshherë i vë pacientët në rrezik. Kjo qasje tradicionale në mjekësi, kombinuar me mungesën e arsimit dhe informacionin e duhur, përbën një rrezik të madh për jetën e shumë njerëzve që jetojnë në zonat e izoluar.

Në vitin 2015, tetë gra të cilat kanë përfunduar Javën e Gruas dhe Akademinë e Grave për Lideritet të NDI, filluan një iniciativë për zbutjen e problemit të kujdesit shëndetësor me të cilin përballen komunitetet rurale në Kosovë. "Shëndetësia është një nga problemet më të mëdha me të cilin përballen njerëzit", tha Edita Veseli, anëtare e nismës "Vetëdijesim për ndihmën e parë". "Ne shpesh dëgjojmë për raste kur shëndeti i fëmijës përkeqësohet si rezultat i trajtimit të papërshtatshëm mjekësor. Në shoqërinë tonë, gratë kujdesen për familjen, kështu që është shumë me rëndësi të punojmë me to, sidomos me ato që jetojnë në zona rurale, për t'i mësuar se si të japin ndihmë të parë."

Qëllimi kryesor i nismës është t'i edukojë 100 gra nga zonat e largëta të fshatrave në afërsi të Ivajës dhe Gajres, pjesë të Komunës së Kaçanikut, në ofrimin e ndihmës së duhur të parë dhe t'i mobilizojë përfaqësuesit e institucioneve përkatëse që trajnimet e ndihmës së parë t'i shtrijnë edhe tek gratë në zona rurale.

Tetë gratë e nismës kontaktuan me Ministrinë e Shëndetësisë për të kërkuar ndihmë, të cilët pastaj i udhëzuan ato tek disa organizata joqeveritare, duke përfshirë Caritas dhe Women for Women International (WfW), për t'i organizuar disa trajnime për rreth 100 gra pjesëmarrëse

¹ <http://hdr.undp.org/sites/default/files/khdr2014english.pdf>



**VETËDIJESIMI PËR
NDIHMËN E PARË**

në teknikat e ndihmës së parë. Përfaqësues të organizatës Caritas i mbajtën trajnimet të cilat të cilat ishin me fokus në trajtimin e problemeve më të shpeshta shëndetësore siç janë temperatura, të vjellat, djegiet dhe lëndimet e tjera trupore. Ato gjithashtu ofruan pako të ndihmës së parë me fasha, jod, peroksid hidrogjeni dhe termometra për të gjitha gratë pjesëmarrëse në trajnim. WfW ka identifikuar disa prej fshatrave më të izoluar të vendit të cilat kishin nevojë që të kenë pjesëtarë komuniteti të trajnuar në ofrimin e ndihmës së parë dhe ndihmuan në përzgjedhjen e grave nga këto fshatra në trajnime.

“Gratë vërtetë vlerësuan punën që e kryem me to, dhe kjo u dëshmuar nga numri i lartë i pjesëmarrësve,” tha Veseli. “Ato gjithashtu ishin mirënjohëse për trajnimet dhe vërejtën se sa e vështirë është për to kur një anëtar i familjes ka nevojë për vëmendje mjekësore.”

Xhejlan Spahiu, pjesëmarrëse në trajnimin e mbajtur në Gajre, shprehi vlerësimin e saj. “Unë mësova shumë informata nga ky trajnim. Për shembull, tani e kuptova se nuk duhet të përdor gjalpë për t’i shëruar djegiet,” tha Spahiu.

“Qëllimi ynë është përmbushur sepse besojmë që të gjitha gratë që kanë marrë pjesë në seancat e trajnimit kanë përvetësuar shkathtësi të reja. Gratë që mësuat se si të japin ndihmë të parë vinin nga disa prej vendeve më të largëta në disa komuna,” tha Veseli. Afërdita Këqiku, infermiere dhe një nga tetë organizatorët e trajnimit, shtoi se arritjet e nismës ishin tepër të rëndësishme.

“Gjatë trajnimeve, ne e pamë se sa e nevojshme ishte kjo me të vërtetë për zonat rurale”, tha Këqiku. “Në këto zona, ambulancat



janë shumë larg. Gjatë dimrit, rrugët janë të pa depërtueshme dhe njerëzit e sëmurë nuk mund të transportohen në spitale, kështu që gratë duhet të kujdesen për ta. Plani ynë për të ardhmen është që t’i zgjerojmë më shumë aktivitetet tona; planifikojmë që të përfshijmë aspektet si planifikimi familjar, higjiena orale, përdorimi i ilaçeve dhe mbrojtja nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme,” shtoi Këqiku.

Përderisa ka shumë për tu bërë, gratë kanë arritur rezultate të konsiderueshme deri më tani. Me ndihmën e Caritas, WfW dhe NDI, grupi arriti t’i këshillojë gratë në praktikat bazike të kujdesit shëndetësor, dhe përfundimisht të kontribuojë që të ketë siguri më të madhe në Kosovën rurale se më parë.

Anëtarët e nismës:

Afërdita Halili Këqiku, Edita Veseli, Marigona Kelmendi, Sevdie Haziri Musliu, Sadete Popaj, Qendresa Sahitaj, Vjosa Sheholli, Vlora Veseli



Ngritja e vetëdijes tek gratë për dhënien e ndihmës së parë në tre fshatra të Komunës së Vitisë



Institucionet duhet të edukojnë gratë rreth Ndihmës së Parë në vendet rurale të cilat nuk kanë qasje në spitale rajonale



Mbledhja e mbështetjes online



Trajnime i 100 grave në vendet rurale të Vitisë



Institucionet e miratuan këtë politikë



Inheritance & Property



/rightforproperty

Historikisht gratë janë privuar nga e drejta e tyre për të trashëguar prona dhe përderisa korniza ligjore e Kosovës rregullon të drejtat pronësore të grave, ato ende vazhdojnë të mos i gëzojnë këto të drejta themelore të tyre. Realizimi i të drejtës së grave në pronë është i lidhur ngushtë me ngritjen e pozitës së grave në familje, fuqizimin ekonomik të gruas, mundësitë e saj për vetëpunësim dhe zhvillim biznesi dhe përmirësim të përgjithshëm të pozitës së gruas në shoqëri.

Ligjet aktuale sigurojnë barazi të plotë në trashëgimi, megjithatë praktika na e dëshmon që kur trashëgimtare është një grua këto të drejta nuk jetësohen në gjykatë. Përqindja e grave që kanë realizuar të drejtën e tyre në pronë në Kosovë është fare e vogël. Të zotuar për ta rregulluar këtë pabarazi, në vitin 2015 një grup i grave të profileve të ndryshme politike themeluan nismën "E drejta e grave në pronë" me qëllim të rritjes së numrit të grave që kuptojnë dhe shfrytëzojnë të drejtën e tyre në pronë.

"Të drejtat pronësore të grave përbëjnë një temë e cilajo shpesh diskutohet në shoqërinë

tonë; vazhdojnë të ekzistojnë paragjykitime lidhur me këtë temë e cila nganjëherë madje konsiderohet tabu," tha Nita Luzha, anëtare e kësaj nisme. "Ne konsiderojmë se mbrojtja e të drejtave të grave në pronë përbën një temë tejet të rëndësishme për fuqizimin e grave në shoqërinë tonë."

Pasi që legjislacioni në Kosovë veç garanton barazi gjinore në të drejtat pronësore, nisma ka zbarkuar në ndryshimin e sjelljes dhe qëndrimeve publike mbi të drejtat pronësore të grave dhe iu ka shmangur paraqitjes së propozimeve të reja politike.

Në bashkëpunim me Programin e USAID për të Drejta Pronësore, kjo nismë ka organizuar seanca diskutimi mes homologësh mbi temën "Ngritja e vetëdijes mbi të drejtat pronësore" me gra dhe studente nga nëntë komuna të ndryshme. Këto gra ishin pjesëtare të të gjitha komuniteteve, përfshirë përfaqësuese të OJQ-ve, përfituese të asistencës sociale, nëna pa bashkëshortë dhe gra me aftësi të kufizuara. Pjesë e planit të nismës është që të punohet me 450 gra në këtë program.



**E DREJTA E GRAVE NË
PRONË DHE TRASHËGIMI**



“Aktivitetet vetëdijesuese, të organizuara në formë diskutimi, janë zhvilluar për të filluar bisedimet dhe debatet mbi të drejtat pronësore të grave,” tha Luzha. “Pjesëmarrëset ndanin përvojat, sfidat dhe storiet e suksesit, por më e rëndësishmja ishte se gratë vërtetë ta kuptonin që të drejtat e grave janë të garantuara me ligjet e Kosovës.”

Në secilën seancë rëndësi e veçantë i kushtohej legjislacionit që garantonte barazi gjinore në të drejtat pronësore dhe domosdoshmërisë së ndryshimit të sjelljeve dhe qëndrimeve sociale në ndërlidhje me të drejtat pronësore të grave. Shumica e studentëve që merrnin pjesë në këto diskutime pajtoheshin për nevojën e ndarjes së barabartë të pronave mes vëllezërve dhe motrave, gjë që bën perspektivën e një të ardhmeje më të ndritur për gratë shumë më të prekshme.


Pas përmbylljes së diskutimeve, nisma është në proces të realizimit të trajnimeve intensive lidhur me të drejtat e

trashëgimisë së pronës për 100 gra të tjera të përzgjedhura nga njëntë komuna të ndryshme.

Përmes diskutimeve grupore dhe seancave të trajnimit, të cilat mbaheshin pothuajse çdo muaj, qindra gra kanë mësuar më shumë lidhur me të drejtat pronësore të tyre dhe, si rrjedhojë, tani i ndajnë mësimet e veta me gratë tjera. Kjo gjeneratë e re e grave të edukuara dhe informuara veç është duke rezultuar me ngritje të zërit dhe kërkim të të drejtave të cilat grave u përkasin me ligj. Siç shprehet Luzha, “Ndryshimi fillon kur të filloni të flisni për ndryshimin, ndërsa ne pas fillimit të diskutimeve në komuna të ndryshme veç kemi filluar ta jetësojmë atë.”

Anëtarët e nismës:

Besa Veseli, Drita Millaku, Nita Luzha Rudi, Majlinda Ostroglava, Violeta Berisha, Shpresa Veliqi, Xhevrie Peci



SINGLE MOTHER INITIATIVE

f /singlemother

Kur një trajnues e pyeti një nënë vetushqyese, Arta Tahirin, “çfarë lloj programi do t’i ndihmonte më së shumti nënat vetushqyese?” ajo u përgjigj menjëherë “Kujdes për fëmijët pa pagesë!”

Në vitin 2012, pjesëmarrëset e Akademisë së Grave për Leadership nga parti dhe organizata të ndryshme të shoqërisë civile themeluan iniciativën avokuese “Nënat vetushqyese”, për t’i identifikuar sfidat kryesore me të cilat përballen nënat vetushqyese dhe për të gjetur zgjidhje për këto çështje.

“Mendua që këtë iniciativë ta nisim për t’i ndihmuar dhe mbështetur nënat vetushqyese”, tha znj. Këshilltare e Kuvendit Komunal të Ferizajt. Iniciativa synonte ngritjen e vetëdijesimit të qeverisë dhe popullit mbi vështirësitë me të cilat përballen nënat vetushqyese çdo ditë. Kur Tahiri shkoi në zyrën e qytetit të saj për shërbime sociale, ajo vërejti se më shumë se 100 nëna vetushqyese në Ferizaj do të mund të përfitonin nga kujdesi i fëmijëve pa pagesë. “Mundësitë për të siguruar kujdes falas për fëmijë në Ferizaj u paraqitën kur takova MuharremSfarqën, Kryetarin e Komunës së Ferizajt dhe propozova idenë dhe mënyrën e realizimit të saj”, theksoi Tahiri. “Kryetari i komunës menjëherë dorëzoi një kërkesë me shkrim në dy kopshte fëmijësh në Ferizaj për ta bërë kujdesin e fëmijëve pa pagesë për të gjitha nënat vetushqyese, dhe po ashtu theksoi se që nga ai moment fëmijët e nënave vetushqyese ‘do të jenë prioritet parësor në procesin e pranimit’.

Kur Arta Sylejmani, burri i së cilës kishte vdekur së fundi, dëgjoi për programin e kujdesit të fëmijëve pa pagesë, ajo ishte e lumtur që më në fund arriti ta dërgojë vajzën e saj që të luajë me fëmijët e tjerë çdo ditë. “Për një nënë vetushqyese me tre fëmijë, të kesh dikë që të ndihmojë madje edhe vetëm për gjysmë ore bën ndryshim të madh. Të qenit jashtë nga mëngjesi deri pasdite është mrekulli”, tha Sylejmani.



INICIATIVA PËR NËNAT
Vetushqyese

“Kjo është në të mirë edhe të vajzës sime,” tha ajo. “Kur ajo është e izoluar në shtëpi për 24 orë, është e pamundur që të mos i mungojë babai. Kur ka mundësinë që të jetë me fëmijë të tjerë, ajo harron dhimbjen e saj.”

Iniciativa vazhdoi të takohet me organizata lokale që merreshin me çështjet e grave, anëtarë të kuvendit, grupe të grave të partive politike, si dhe kryetarë të komunave të ndryshme për t'i vlerësuar hapat e ardhshëm për të siguruar qasje në kujdes të fëmijëve pa pagesë për të gjitha nënat vetushqyese në Kosovë.

“Mbështetjen më të madhe e kemi marrë nga organizatat e shoqërisë civile,” tha Merita Mustafa, anëtare e iniciativës. “Unë besoj se iniciativa jonë ishte e suksesshme pikërisht sepse i kemi kombinuar forcat e grave dhe kemi punuar me pasion në një çështje që ishte mjaft personale për ne, sepse edhe ne kemi qenë të prekura nga padrejtësitë e tilla ose kemi pasur anëtar të familjes që e ka përjetuar atë.”

Bashkëpunimi i iniciativës me shoqërinë civile përfshinte punën me shoqatën NORMA, shoqatë kjo e juristeve për të drejtat e grave, duke organizuar një sërë tryezash të rrumbullakëta në shtatë rajone të Kosovës, me titull “Nënat vetushqyese dhe fëmijët nën kujdesin e tyre: Sfidat për zbatimin e Ligjit për Familjen”.

“Bashkëpunimi ynë me shoqatën NORMA ishte shumë produktiv, posaçërisht sepse ata e kishin ekspertizën ligjore, gjersa ne e kishim pasionin dhe vullnetin për t'i ndihmuar nënat vetushqyese dhe fëmijët e tyre,” tha Mustafa. Përmes tryezave të rrumbullakëta, shumë palë të interesit arritën t'i ndajnë praktikën më të mirë dhe t'i harmonizojnë përgjegjësitë institucionale për trajtimin e sfidave në zbatimin e ligjit.

Në vitin 2016, katër vite që nga themelimi, synimet fillestare të iniciativës për ta bërë çështjen të rëndësishme për institucionet dhe publikun janë arritur në masë të madhe. Për herë të parë, nënat vetushqyese janë pjesë e agjendës së avokimit të Komisionit Evropian. Si rrjedhojë, dy organizata joqeveritare në Kosovë kanë pranuar grante për të kryer hulumtim mbi nënat vetushqyese. Për më tepër, Grupi i Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës ka ofruar mbështetjen e plotë për iniciativën duke e ngritur këtë çështje në kuvend dhe duke e përfshirë atë në planin e tyre të punës, si dhe i përgëzuan anëtarët e AGL për ngritjen e çështjes. Për më tepër, Komuna e Lipjanit u bë komuna e dytë në Kosovë që miratoi politikën e iniciativës për ofrimin e kujdesit ditor për fëmijë pa pagesë për fëmijët e nënave vetushqyese, dhe iniciativa vazhdon të punojë në realizimin e kësaj në të gjitha komunat e Kosovës.

Edhe pse të kënaqura me rezultatet e arritura deri më tani, Tahiri thotë se ka shumë për t'u bërë në këtë iniciativë. “Projekti ynë do të përfundojë kur të gjitha komunat e përqafojnë idenë tonë të kujdesit për fëmijë pa pagesë,” theksoi Tahiri. “Prandaj, plani për të ardhmen është që Ministria e Arsimit të nxjerrë udhëzime administrative që do të siguronin se të gjitha nënat vetushqyese lirohen nga pagesa e kujdesit për fëmijë në Kosovë.”

Nga shtatori 2016, Ministria e Arsimit miratoi një udhëzim administrativ që i mundëson fëmijët e grupeve të marginalizuara, duke përfshirë fëmijët e prindërve vetushqyës, të lirohen nga pagesa. Këta fëmijë pastaj do të kenë përparësi gjatë regjistrimit në institucione publike të kujdesit ditor, duke siguruar kështu qasje në arsim për të gjithë.



Mirëqenie për nënat e vetme dhe fëmijët për të cilët ato kujdesen; Zbatimi i Ligjit mbi Familjen



Komunat të miratojnë përkujdesje ditore pa pagesë për fëmijët e nënave të vetme



Mbledhja e mbështetjes nga institucionet



Tryezë të rrumbullakët në nivel vendi dhe lokal



Ministria e Arsimit e miratoi këtë politikë në nivel vendi



**Smaller
classrooms -
Better education**

 /smallclassedu

Ministria e Arsimit e Kosovës ka nxjerrë në qershor të vitit 2013 një udhëzim administrativ për të kufizuar numrin e nxënësve në 35 për klasë, por shumë prej palëve me interes vazhdojnë ta konsiderojnë këtë numër tepër të lartë për zhvillimin e një arsimi cilësor. Për më tepër, ky udhëzim fare rrallë respektohet në shumë shkolla të Prishtinës dhe Fushë Kosovës, ku klasët kanë edhe nga 40 nxënës.

Në vitin 2014, një grup i aktivisteve deshi të bënte diçka lidhur me këto klasa të stërngarkuara. Këto gra, pjesëmarrëse në Akademinë e Liderit të Grave të NDI, vendosën të vënë në funksion aftësitë e tyre komunikuese dhe të zhvillimit të politikave publike për të formësuar iniciativën avokuese "Klasë më të vogla, arsim më i mirë."

Saranda Bllaca, anëtare e kësaj nisme, tha se arsyeja për formimin e kësaj nisme ishte cilësia e ulët e arsimit në Kosovë. "Ne kemi vendosur të avokojmë për këtë çështje me qëllim të ndërrimit të udhëzimit administrativ me të cilin rregullohet madhësia e klasës, pasi që me nga 30 deri 35 nxënës për klasë nuk mund të premtohet ngritje e cilësisë së arsimit," tha ajo. Shumë zyrtarë të shkollave janë pajtuar me këtë nismë, pasi që madhësia e klasave është ndërlidhur me rezultate më pozitive arsimore për nxënësit, që nga përmirësimi i rezultateve të testit deri tek zvogëlimi i numrit të largimit nga shkollimi dhe rritja e normës së diplomimit. Këto përmirësime i atribuohen aftësive të mësimeve për tu ofruar më shumë kujdes nevojave specifike të nxënësve, si dhe kujdesit të shtuar të nxënësve ndaj mësimi në grupe më të vogla.

Udhëheqëset e kësaj nisme besonin fuqishëm se udhëzimi administrativ duhet të ndryshohet për të kufizuar numrin në 20 deri 25 nxënës dhe se kjo do të përmirësojë cilësinë e arsimit në Kosovë. Ato janë duke ndërtuar përkrahjen publike për të avokuar për ndryshim dhe janë duke u takuar me deputetë, anëtarë të Komisionit për Arsim të Kuvendit të Kosovës, zyrtarë të Ministrisë së Arsimit, drejtorive për arsim në nivel lokal dhe palëve tjera me interes që punojnë në sektorin e arsimit.



**KLASA MË TË VOGLA,
EDUKIM MË I MIRË**


Për të kuptuar më mirë situatën, nisma ka kryer vizita në terren në dhjetë shkolla në shtatë komuna të Kosovës – Gjilan, Viti, Gjakovë, Prishtinë, Fushë Kosova, Mitrovicë dhe Hani Elezit. Pas vlerësimit të këtyre klasave, anëtarët e nismës e kuptuan se tejngarkimi i klasave është më i rëndë se sa që është pritur, duke qenë se shumica e klasave të vizituara tejkalonin normën e udhëzimit administrativ. Më pas, nisma organizoi vizita në drejtoritë për arsim në disa komuna të Kosovës.

Elvirë Bushi, anëtare e nismës, tha se vizitat në terren i siguronin ato se disa pjesë të sistemit arsimor vërtetë duhet ndryshuar. “Të gjithë njerëzit me të cilët kemi biseduar na kanë inkurajuar që të vazhdojmë me punën tonë,” tha ajo. [Gjatë vizitave] mësova më shumë për problemet e ndryshme me të cilat përballen shkollat çdo ditë dhe u vërtetova se zvogëlimi i numrit të nxënësve për klasa do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e arsimit.”

Ishin të shumtë drejtorët e drejtorive të arsimit, drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit që shprehnin gatishmërinë e tyre për të arritur caqet e përcaktuara nga nisma.

Nisma do të vazhdojë me aktivitete avokuese në muajt në vijim, për të mbajtur një takim të përbashkët me Komisionin për Arsim të Kuvendit të Kosovës, për të paraqitur gjetjet e veta dhe ofruar rekomandime për shmangien e tejngarkimit të klasave.

“Rekomandimi kryesor që ne mëtojmë ta paraqesim para Komisionit të Arsimit”, shtoi Bllaca, “është që Komisioni të rishqyrtojë udhëzimin administrativ pasi që ai nuk e ka përmirësuar cilësinë e arsimit dhe nuk është duke u zbatuar dhe respektuar si duhet.”




“Zvogëlimi i numrit të nxënësve nëpër klasa është parakusht i domosdoshëm për ngritjen e cilësisë së arsimit,” sqaron Bushi. “Kur punoni në grupe, kur punoni në implementimin e metodave moderne të mësimdhënies, është e pamundur të punohet me numër të madh të nxënësve. Mendoj se ndryshimet në këtë drejtim duhet të realizohen sa më shpejt që është e mundur.”

Nisma ka cekur se me përmirësim të rezultateve arsimore, gjeneratat e reja do të kenë më shumë mundësi punësimi dhe do të jenë ekonomikisht më të forta, prandaj nisma do të vazhdojë të punojë deri në arritjen e cakut të vet.

Anëtare të nismës:

Ajnisha Haziri, Elvirë Bushi, Jetmira Rexhepi, Mirlinda Sopi, Saranda Bllaca



Përpilimii kësaj broshure u mundësua me përkrahjen e popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) Marrëveshja për Bashkëpunim Nr. 167-A- 00-09- 00106-00 - 00350-00 nën Marrëveshjen Leader Cooperative Nr. DFD- A- 00-08- 00350-00. Mendimet e shprehura këtu i takojnë autorit/autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmëri pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara

Copyright © National Democratic Institute 2016. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Pjesë të këtij punimi mund të përdoren dhe/ose të përkthehen për qëllime jofitimprurëse me kusht që NDI të njihet si burim i materialit dhe t'i sigurohet kopje e çdo përkthimi.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

